



UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA"
FAKULTETI AGROBIZNESIT

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E STUDENTËVE

Universiteti "Haxhi Zeka"/Fakulteti i Agrobiznesit garanton transparencë dhe qartësi në komunikim duke siguruar publikimin e të drejtave dhe detyrimeve të studentëve si pjesë e standardeve institucionale të cilësisë.

I. Të drejtat e studentëve:

Nr.	Të drejtat
1	Të kenë qasje në informacione të plota dhe të sakta mbi programet studimore, kriteret e pranimit, proceset e vlerësimit dhe rezultatet e synuara të të nxëniet.
2	Të informohen në mënyrë transparente për konkursin e pranimit, sistemin e pikëzimit, ranglistat dhe procedurat e apelimit.
3	Të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, pavarësisht prejardhjes, gjinisë, moshës apo statusit social, në përputhje me ligjin dhe aktet e UHZ-së.
4	Të kenë qasje në sistemin SEMS dhe informacionet mbi përparimin e tyre akademik, si dhe në statistikatat dhe raportet për përparim që përgatiten nga koordinatori dhe Zyra e Cilësisë.
5	Të përfitojnë nga sistemi tutorial , konsultimet me profesorë dhe asistentë, dhe oraret zyrtare të këshillimit akademik dhe profesional.
6	Të informohen dhe të mbështeten për pjesëmarrje në programe të mobilitetit ndërkombëtar (në shkuarje dhe në ardhje), përmes Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zyrës për Zhvillim të Karrierës.
7	Të kenë qasje në shërbime dhe burime mbështetëse (bibliotekë, laboratorë, terrene praktike, shërbime IT, këshillim akademik dhe karriere, aktivitete jashtëshkollore).
8	Të informohen për procedurat e ankesave dhe apeliemeve , si dhe për mekanizmat institucionalë (komisionet, këshillat, senati) që merren me to.
9	Të marrin dokumentet zyrtare (vërtetime, transkripta, diploma) brenda afateve të përcaktuara.

II. Përgjegjësitë e studentëve:

Nr.	Përgjegjësitë
1	Të respektojnë Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka", rregulloret për studime Bachelor dhe Master, si dhe rregulloret të tjera relevante.
2	Të paraqesin dokumentacion të saktë dhe të plotë gjatë aplikimit dhe regjistrimit, në përputhje me kriteret e konkursit.
3	Të marrin pjesë rregullisht në ligjërata, ushtrime, punë laboratorikr, praktikë dhe aktivitete tjera të programit, duke përmbushur detyrimet mësimore.
4	Të ruajnë integritetin akademik , duke shmangur plagjiaturën, kopjimin dhe çdo formë tjetër të shkeljes akademike.
5	Të shfrytëzojnë në mënyrë të përgjegjshme pajisjet laboratorike, infrastrukturën universitare, terrenet praktike dhe burimet tjera të fakultetit.
6	Të bashkëpunojnë me sistemin tutorial, të marrin pjesë në konsultime dhe, kur është e nevojshme, të kërkojnë ndihmë apo këshillim nga stafi akademik dhe administrativ.
7	Të respektojnë procedurat për ankesa dhe të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë përmes plotësimit të pyetësorëve dhe dhënies së feedback-ut në SEMS.
8	Të respektojnë afatet dhe detyrimet financiare (tarifat e shkollimit dhe administrative) sipas rregulloreve të UHZ-së.
9	Të promovojnë sjellje të përgjegjshme, kulturë akademike dhe pjesëmarrje aktive në aktivitetet jashtëshkollore, kulturore, vullnetare dhe sportive të organizuara nga universiteti.